VENDIM
Nr. 478, datë 31.7.2018

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SHTESË TË KONCESIONIT, PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË KONTRATËN E KONCESIONIT, "PËR NDËRTIMIN, PËRMIRËSIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E AUTOSTRADËS MILOT-MORINË", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 870, DATË 14.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, të nenit 34, të rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale, të miratuar me vendimin nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 504, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës shtesë të koncesionit, për një ndryshim dhe shtesë në kontratën e koncesionit, "Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot–Morinë", të miratuar me vendimin nr. 870, datë 14.12.2016, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
Nr. _____ Rep.
Nr. _____ Kol.

KONTRATË SHTESË KONCESIONI
PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË KONTRATËN E KONCESIONIT "PËR NDËRTIMIN, PËRMIRËSIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E AUTOSTRADËS MILOT–MORINË" TË LIDHUR NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS DHE KONSORCIUMIT *CATALYST VIVA DAS GENERAL CONTRACTING,* LLC-SALILLARI SHPK - *BEE TECH-VIOLIAP ATEVE* - KASTRATI SHA"

Në Tiranë, në datën 26, muaji korrik, viti 2018 (dy mijë e tetëmbëdhjetë), para meje, noter _____, anëtar i Dhomës së Noterisë_____, me adresë _____, u paraqitën palët kontraktuese, si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësuar me autorizimin nr. 10031 prot., datë 18.7.2018, nga Sekretari i Përgjithshëm z. Gentian Këri, shtetas shqiptar, i datëlindjes 31.3.1977, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga ID, me nr. personal H70331054P.

dhe

Shoqëria koncesionare "Albanian Highway Concession" sh.p.k., regjistruar si person juridik

në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NIPT: L62427021G, me seli në adresën Vorë–Marikaj, km 1, Vorë, Tiranë, përfaqësuar nga administratori z. Nicola Spadavecchia, shtetas italian, lindur në Molfetta (BA), në datën 1.1.1950, mbajtës i letërnjoftimit ID, me nr. personal AA4576373, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Palët, të cilat me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë kontratë koncesioni shtesë, si pjesë përbërëse e kontratës bazë të koncesionit të nënshkruar nga palët Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Konsorciumi *Catalyst Viva Das General Contracting,* LLC-Salillari sh.p.k. - *Bee Tech-Violiap Ateve* - Kastrati sh.a.

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

- Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 634, datë 1 tetor 2014, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe të shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale", të ndryshuar, dhe dokumentacionit të procedurës së koncesionit, datë 27 prill 2016, autoriteti kontraktor ftoi ofertuesit për të paraqitur ofertat e tyre për përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot–Morinë.
- Pas përfundimit të procesit të koncesionit, KDHK, konstatoi se Catalyst&Salillari sh.p.k. &Violiap&Bee Tech&Kastrati sh.a. ishte ofertuesi më i mirë dhe e zgjodhi atë si koncesionar për të realizuar projektin, sipas kushteve të marrëveshjes së koncesionit të propozuar.
- Në datën 6 dhjetor 2016, Palët kanë nënshkruar kontratën e koncesionit "Për ndërtim, përmirësim, shfrytëzim, mirëmbajtje të autostradës Milot–Morinë", miratuar me vendimin nr. 870, datë 14.12.2016;
- Kontratën nr. 508/4, datë 14.6.2017, për shërbime konsulence për "Inxhinier të pavarur për Projektin e Koncesionit të Autostradës Milot–Morinë";
- Raportin e vlerësimit teknik të hartuar nga inxhinieri i pavarur (mbikëqyrësi);
- Raportin teknik të hartuar nga koncesionari;
- Aktin e dorëzimit datë 9.9.2017 të Tunelit të Thirrës;
- Raportin nr. 4995/1 prot., datë 16.4.2018 "Mbi zbatimin e urdhrit nr. 125, datë 30.1.2018, "Për verifikimin e defekteve të fshehta në Tunelin e Thirrës si dhe për vlerësimin tekniko-ekonomik të pajisjeve të funksionimit dhe operimit të këtij tuneli";
- Korrespodencat nga Koncesionari dhe inxhinieri i pavarur (mbikëqyrësi) drejtuar MIE-s, mbi defektet e fshehta në Tunelin e Thirrës, bashkëlidhur të cilave janë dhe oferta ekonomike nga shoqëri të ndryshme për pajisjet e tunelit që përfshihen në defektet e fshehta të tij;
- Shkresën nr. 4995/5, datë 20.6.2018 të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MIE;
- Në pikën 20A, "Defektet e fshehta", ndër të tjera cilësohet se: "Gjatë periudhës së përgjegjësisë për defektet e fshehta, nëse koncesionari beson se në atë kohë ka dalë në pah një defekt i fshehtë, me kërkesën e autoritetit kontraktor, koncesionari rregullon defektin e fshehtë (me anë të riparimit ose të zëvendësimit, sipas zgjedhjes së koncesionarit), dhe kostoja e një riparimi apo zëvendësimi të tillë përballohet nga autoriteti kontraktor ...";
- Në pikën 57, "Amendamentet e Marrëveshjes", cilësohet se: Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me anë të amendamenteve me shkrim të nënshkruara nga të dyja palët;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 13.9.2017, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë",

Për këto arsye,

Palët bien dakord që në kontratën bazë të koncesionit të nënshkruar nga palët Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Konsorciumi *Catalyst Viva Das General Contracting,* LLC-Salillari

sh.p.k. - *Bee Tech-Violiap Ateve* - Kastrati sh.a., në datën 6.12.2016, "Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot–Morinë", të miratuar me vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2016, të bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

I. Në kontratën bazë të koncesionit "Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot–Morinë", kudo në kontratë, togfjalëshi: "Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës", të zëvendësohet me togfjalëshin "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë".

II. Të shtohet aneksi i kontratës nr. 3, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Aneks kontrate nr. 3 i kontratës së koncesionit

1. Shoqëria koncesionare do të rregullojë defektin e fshehtë (me anë të zëvendësimit), sipas vlerësimit të kostos së rregullimit të defekteve të fshehta sipas afateve të përcaktuara në tabelën nr. 1 bashkëlidhur.

2. Shoqëria koncesionare do të mbajë përgjegjësi të plotë për ekzekutimin e punimeve dhe rivendosjen e Tunelit të Thirrës, në gjendje të sigurt operimi, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së koncesionit.

3. Punimet për rregullimin e defektit të fshehtë në Tunelin e Thirrës do të përballohen fillimisht nga shoqëria koncesionare dhe më pas me sigurimin e fondeve nga autoriteti kontraktor, do të kryhet rimbursimi i kësaj vlere shoqërisë koncesionare, për aq sa do të faturohet, por jo më shumë se vlera e përcaktuar në tabelën nr. 2 bashkëlidhur këtij aneksi të kontratës.

4. Afati i rregullimit të defektit të fshehtë nga shoqëria koncesionare është brenda 20 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj shtese të kontratës së koncesionit.

5. Palët bien dakord dhe pranojnë se ky aneks nr. 3, është pjesë e pandashme e kontratës së koncesionit.

III. Kjo kontratë shtesë, hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar dhe të pikës 5, të nenit 34, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 634, datë 1.10.2014, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale", të ndryshuar.

Kjo kontratë shtesë u hartua në 4 (katër) dublikata origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe, ku secila palë mban 1 (një) dublikatë të origjinalit në gjuhën angleze dhe shqipe dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht.

PALËT
AUTORITETI KONTRAKTUES
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Përfaqësuar nga:
Z. Gentian Këri

SHOQËRIA KONCESIONARE
"Albanian Highway Concession" sh.p.k.
Përfaqësuar nga:
Z. Nicola Spadavecchia